



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

V E N D I M

Nr. 92, Datë 23/05/2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.73, datë 05.05.2022, e znj. M.K., përfaqësuar pranë KMD-së me prokurë të posaçme N. Rep. 1790, Nr. Kol. 418, datë 21.12.2021, nga Av. B.R.dhe Av. E. H., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjes politike*” dhe “*gjendjes arsimore*” nga ana Spitalit Rajonal “Xhaferr Kongoli”, Elbasan.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Referuar ankesës së depozituar pranë Komisionerit, ankuesja M.K. ka punuar pranë Spitalit Rajonal “Xhaferr Kongoli” Elbasan, për një periudhë prej 22 vitesh. Ajo ka punuar në pozicione të ndryshme pune të tillë si: specialist biostatiste, kimiste në farmacinë e spitalit, kryelaborante, e më pas laborante e thjeshtë. Ankuesja shprehet se gjatë gjithë kësaj periudhe kohore ka punuar me përkushtim dhe ka qenë korrekte në kryerjen e detyrës së saj. Ajo vë në dukje faktin se ka kryer disa kualifikime pasuniversitare, duke filluar nga Masteri Shkencor për Biologji Molekulare e duke vijuar me fitimin e titullit “Doktor i Shkencave” në të njëjtën degë. Subjekti ankues sqaron se për të janë lëshuar rekomandime dhe vlerësime të shkëlqyera.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Në vitin 2021, Spitali Xhaferr Kongoli Elbasan ka lidhur një Kontratë Koncesionare me një partner privat, nga ku u vendos që pjesa e laboratorit t'i kalonte partnerit privat. Punonjësit janë vënë në dijeni të këtij fakti, por pa patur informacion të mëtjshëm mbi vazhdimësinë e marrëdhënies së punës. Çdo punonjës është marrë në intervistë, ndër të cilët edhe znj. M.K., e cila ka shprehur gatshmërinë dhe vullnetin për të vazhduar marrëdhënien e punës me subjektin privat. Pas disa ditësh, asaj i është komunikuar zyrtarisht zgjidhja e kontratës së punës në datën 15.10.2021, me Spitalin "Xhaferr Kongoli" Elbasan nëpërmjet shkresës nr. 1546 prot., datë 15.10.2021, të Spitalit "Xhaferr Kongoli" Elbasan dhe mosvazhdimësia e marrëdhënies së punës me subjektin privat. Referuar shkresës së sipërcituar rezulton se zgjidhja e kontratës së punës së ankueses me këtë institucion mjekësor ka qenë zbatimi i Kontratës Koncesionare nr. 1942/2, për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore, si dhe shkresës nr. 81/56 prot., datë 22.06.2021 së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Subjekti ankues pretendon se i është dhënë shpjegim verbalisht se kontrata e saj e punës është zgjidhur pasi ajo është e mbikualifikuar.

Për sa më sipër, ankuesja pretendon se është diskriminuar nga Spitali "Xhaferr Kongoli" Elbasan për shkak të bindjes së saj politike dhe për shkak të gjendjes së saj arsimore.

II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dha akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoj se kjo ankesë duhej plotësuar me informacion vijues. Për këtë arsye, Komisioneri iu drejtua Av. B. R., në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të ankueses M.K., me shkresën nr. 704/1, datë 11.05.2022, ku iu kërkua të përcillte pranë KMD-së, informacionin e mëposhtëm brenda 3 (tre) ditëve nga marrja dijani mbi shkresën. Informacioni i kërkuar konsistonte në çështjet e mëposhtëme:

- 1. "Informacion mbi bindjet politike të ankueses. Të depozitohen fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë këto bindje, të tilla si: kopje e kartës së anëtarësisë në subjektin përkatës politik, vërtetime për pjesëmarrje në aktivitetin politik të këtij subjekti, fushata zgjedhore, komisione numërimi etj.*
- 2. Të jepen shpjegime mbi lidhjen shkakësore ndërmjet bindjes politike të ankueses dhe trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit ajo pretendon se është ekspozuar nga ana e Spitalit Rajonal "Xhaferr Kongoli", Elbasan.*
- 3. Të jepen shpjegime mbi lidhjen shkakësore ndërmjet gjendjes arsimore të ankueses dhe trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë ndaj së cilit ajo pretendon se është ekspozuar nga ana e Spitalit Rajonal "Xhaferr Kongoli", Elbasan.*
- 4. Kopje e kontratës së punës dhe aktit të emërimit në detyrë të ankueses pranë Spitalit Rajonal "Xhaferr Kongoli", Elbasan;*
- 5. Kopje e librezës së punës;*

6. *Informacion nëse zgjidhja e kontratës individuale të punës është duke u shqyrtuar gjyqësisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Nëse kjo gjykatë është shprehur me vendim, të depozitohet në cilësi prove, kopje e këtij vendimi;*
7. *Informacion nëse ankuesja ka patur masa disiplinore në fuqi, në momentin e zgjidhjes së kontratës së punës;*
8. *Kopje të vlerësimeve të punës së znj. M. K., nëse disponohen nga pala ankuese;”*
 - Subjekti ankues nuk i dërgoi përgjigje shkresës së sipërcituar së Komisionerit, as brenda afatit të përcaktuar në këtë shkresë dhe as tej këtij afati, megjithesë ka marrë dijeni mbi të.³
 - Strukturat e KMD-së u munduan të kontaktonin me Av. B. R. disa herë në numrin të tij të celularit⁴, por avokati nuk e hapi telefonin për të komunikuar.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të bindjes politike dhe gjinisë dhe për çdo shkak tjetër duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimorë ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën

³ Referuar aktit Lajmërimarrje rezulton se përfaqësuesi ligjor i ankueses ka marrë dijeni mbi shkresën e KMD-së në datën 12.05.2022.

⁴ Në datën 19.05.2022, u krye tentativa e fundit për të kontaktuar me av. Baftjar Rusi nëpërmjet telefonit celular.

dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ky ligj në nenin 12, pika 1, gërma c) se: *“1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;”*

Në bazë të dispozitave të LMD, të ndryshuar, ankesat e depozituara pranë KMD-së shqyrtohen nga ky institucion dhe në përfundim të procedurave hetimore Komisioneri shprehet me vendimmarrje, nëpërmjet së cilës kryesisht konstaton ose jo diskriminimin e pretenduar për një ose disa nga shkaqet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji.

Për sa më sipër, subjekti ankues parashtron pretendimet e tij lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës, duke e cilësuar si diskriminim për shkak të bindjes politike dhe gjendjes arsimore, ndërkohë që nuk jep asnjë informacion, se cilat janë bindjet politike të znj. M. K. dhe përse largimi nga puna lidhet me këto bindje. Njëkohësisht, ankuesja pretendon se diskriminohet për shkak të gjendjes së saj arsimore, pasi verbalisht i është thënë se është e mbikualifikuar, ndërkohë që nuk jep asnjë sqarim se përse mbikualifikimi i saj, i cili normalisht konsiderohet si bonus i çdokujt në marrëdhëniet e punës, për rastin e saj do të konsiderohej në të kundërtën. Në kushtet kur, laboratorit i Spitalit “Xhaferr Kongoli”, Elbasan është marrë në administrim nga një partner privat, Komisioneri gjykon se mbikualifikimi dhe përvoja e punës së punonjësve aktualë të këtij laboratorit do të ishte në interesin e drejtpërdrejtë të këtij subjekti, përveçse nëse do të kishte arsye të tjera për të mospranuar vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës.

Në kushtet e mungesës së informacionit, KMD i dërgoi shkresës zyrtare përfaqësuesit ligjor të ankuses, ku i kërkoi informacionin e nevojshëm për të filluar hetimin e kësaj ankese. Përfaqësuesi ligjor i znj. M. K. edhe pse mori dijeni mbi shkresën e sipërcituar nuk i dërgoi përgjigje KMD-së dhe as nuk dërgoi shpjegimet dhe aktet e kërkuara për fillimin e procedimit administrativ të Komisionerit.

Për sa më sipër, shkakut i diskriminimit përbën një element kyç në hetimin administrativ të Komisionerit dhe si i tillë, para pranimit për shqyrtim të ankesës së depozituar nga ankuesit,

duhet vërtetuar *së pari* ligjshmëria e tij, si dhe *së dyti* duhet mbështetur provueshmëria e tij. Shkaku i diskriminimit të pretenduar nga ankuesja është “bindja politike”, për të cilën ankuesja nuk ka depozituar fakte dhe prova që ta vërtetojë këtë shkak. Njëkohësisht, edhe shkaku vijues i pretenduar nga ana e saj “gjendja arsimore” nuk rezulton i mbështetur në sqarimet dhe shpjegimet e dhura nga ana e saj.

Në nenin 33, pika 4, gërma b) të LMD, të ndryshuar parashikohet se “Ankesa nuk pranohet kur.... ç)ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”. Në rastin konkret, KMD gjykon që ankesa nr. 73/2022 nuk mund të pranohet pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.

Për sa më sipër, KMD gjykon se ankesa e znj. M. K. nuk pranohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 21, pika 1, nenin 12, pika 1 gërma c), nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr.73, datë 05.05.2022, së znj. M.K., pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Punësim
Shkak- bindja politike, gjendja arsimore
Lloji i vendimit - Mospranim

